



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës

Opština Priština – Municipality of Prishtina



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

616-22-5440-2-2-1/C880

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

PROFESSIONAL ALARM L.L.C., me numër te regjistrimit te biznesit 810321498 adresa ENVER MALOKU, 108, PRISHTINË, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim: Digitalizimi i shërbimeve dhe proceseve te punes me numër identifikues: 616-22-5440-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: "Digitalizimi i shërbimeve dhe proceseve te punës"

Nr.	616-22-028-221/1
1	Digitalizimi i shërbimeve dhe proceseve te punes

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(ët) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi nga data qe do te caktohet ne planin e menaxhimit dhe përfundon në afatin prej 36 muajve.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Kontrata përfundon ne afatin prej 36 muajve.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Komuna e Prishtines

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 44 830,00 Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është +/-30%.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparsisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparsisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvçe nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenojen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen shqipe në kater origjinalë, tri origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Nexhami Mekolli	Emri:	TAFË BLAKAJ
Udheheqes i prokurimit	Pozita:	MENAXHER I SHITJES
 29-07-2022	Nënshkrimi:	 29.07.2022





	Vula:	
--	-------	--

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palë” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2

Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3

Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvëg në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvëç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofroresi i Shërbimeve duhet te njofoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroresi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh llichje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshire në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonësë Ofroresi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofroresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofroresi i Shërbimeve do të njofoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofroresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetë të tillë alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rendë të keqë jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjyki që ka forcën e *res judicata* përmashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përti zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera përm Ofruesin e Shërbimeve derisa të janë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, përm të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërtet kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve përm një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim përm ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve përm humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrofesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofrofesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofrofesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbytjesh kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofrofesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofrofesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofrofesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofrofesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofrofesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofrofesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofrofesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrofesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofrofesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrofesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroresi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofroresi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroresit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofroresi i Shërbimit

15.1 Ofroresi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroresi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofroresi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroresi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit Kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me konratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periuðha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dherose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim te ZKA-se.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës totale te kontrates me vlefshmëri prej 37 muajsh
Parimet përgjithshme pagesës	16.1	<p>Kerkesat per pagesë do te behen per shërbime te performuara ne baza mujore (ex post).</p> <p>Pagesa do te autorizohet dhe do te behet nga Autoriteti Kontraktues per shërbimet e performuara ne baza mujore(Ex Post).</p> <p>Nuk aplikohet pagesë paraprake.</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	<p>Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>Inspektimi do te behet nga persona te caktuar nga ZKA.</i></p> <p>Periudha e përgjegjësise së Defekteve është <i>24 muaj per paisje nga dita e pranimit teknik.</i></p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) <i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</i></p> <p><i>ose</i></p> <p>b) <i>kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përpunhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i></p> <p><i>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</i></p>

DIGITALIZIMI I SHERBIMEVE DHE PROCESEVE TE PUNËS

NR.	PËRSHKIMI	Njësia	SASIA	ÇMIMI ME TVSH	SHUMA TOTALE ME TVSH
1	<p>Kontroller i rrjetit me mundësi te lidhjes deri minimum luexues (kontrollim 30 dyer) sipas specifikimit meposht apo me te avansuar:</p> <p>Kontrolleri i rrjetit duhet te përkrahë me minimum 30 kontrollues aksesi, duhet te kete minimumi 6x hyrje per hapje dhe mbyllje normale (NO/NC) të , minimale 4x dalje tranzistore minimum 1A/15VDC dhe minimale 2 dalje rele 1A ose 1.5A /30VDC.</p> <p>Duhet te kete port të komunikimit 10BASE T, 10/100Mb.</p> <p>Kontrolluesi i rrjetit duhet të jetë në gjendje të lidhë lexuesit e (kontrolluesit) nëpërmjet komunikimit RS-485 në një distancë deri ne 1000 m.</p> <p>Duhet te kete Protokolli te koduar te komunikimit AES 128 CBC ose ekuivalent, të kete bufer (memorej) te integruar te ngjarjeve (minimumi 200 000 transaksione) si dhe me mundesi me te zgjerimit me në kartë memoruese deri në 25 milionë transaksione.</p> <p>Duhet të ketë tension te furnizimit 24VDC diapazoni min/maksimumi 22-26VDC; Gama min/maksimumi 18VAC 17-22VAC ose 12VDC diapazoni 10-15VDC</p> <p>Duhet të ketë funksionin karikimin dhe monitorimin e baterisë rezervë. Funksione tjera shtesë të përgjithshme si zonat e alarmit dhe zonat e pasme kundër kalimit. Gjithashtu, kontrolluesi i rrjetit duhet të mbështesë integrimin e softuerit për panelet e alarmit të ndërhyrës dhe menaxhimin e minimum 10 bravave të dyerve me Wifi nëse është e nevojshme në të ardhmen. Klasa mjedisore sipas kushteve të përgjithshme të brendshme EN 50131-1, temperaturo: +5°C deri +40°C Deklarata e konformitetit EC, EN 50130-4 EMC (CE)</p>	copë	6	720.00 €	4,320.00 €
2	<p>Lexues (kontroller) i kartelave kompatibil me kontrollerin e rrjetit ne pozicionin nr.1</p> <p>Lexusi kontroller duhe kete MIFARE te integruar per lexim te kartelave ne frekuencë 13,56 MHz</p> <p>Duhet te kete mundesin e lidhjes edhe te një lexuesi me qellim te kontrollimit te dyerve me dy drejtime, duhet te mbështes edhe lexuesit e gjurmëve të gishtërinjve.</p> <p>Duhet të ketë minimalist 2 hyrje të programueshme per hapje dhe mbyllje normale (NO/NC) dhe mbyllje normale me të programueshme minimum 1A</p> <p>Komunikimi ndërmjet lexuesit dhe kontrolluesit të rrjetit duhet të jetë BUS (seri) përmes komunikimit RS485, topologjia e lirë e yllit të komunikimit ose topologjia e pemës së lejuar.</p>	copë	50	170.00 €	8,500.00 €

		<p>Lexuesi kontrollor duhet të mbështesë minimum 3500 përdorues, minimum 80 orare dhe minimum 200 grupe përdoruesish.</p> <p>Gjithashtu duhet të ketë integruar një memorie te brendshme per ruajtjen e minimum 30.000 ngjarjesh</p> <p>Lexuesi (kontrolluesi) duhet të ofrojë mundësinë e kontrollit të ashensorëve përmes moduleve të zgjerimit.</p> <p>Te kete mundësin e menaxhimi nëpërmjet Ethernetit (LAN/WAN), USB ose COM</p> <p>Te dorezohet deklarata e konformitetit EC, EN 50130-4 EMC (CE)</p>				
3	Zgjerues	<p>Zgjerues per minimumi 6 Hyrje/Dalje per hapje normale (N/O) dhe mbyllje normale (N/O)</p> <p>Te kete minimum një rele dalese me një kontakt të vetëm hapur/normal/mbyllur me minimum 1.5A/30VDC.</p> <p>Zgjeruesi gjithashtu mund të funksionojë në modalitetin e pavarur si modul rele.</p>	copë	6	70.00 €	420.00 €
4	Furnizues tensioni me mbushes te baterisë	<p>Furnizuesi tensioni për furnizim të pandërprerë</p> <p>Furnizuesi duhet të jetë DC 13,8V/5A furnizim të pandërprerë + 0,5A</p> <p>Furnizimi i pandërprerë minimal DC 13,8V/5A + 0,5A</p> <p>Rryma e karikimit të baterisë, streha e baterisë: 40Ah/12V</p> <p>Gama e tensionit të furnizimit universal AC 176÷264V</p> <p>Karikimi i baterisë dhe kontrolli i mirëmbajtjes</p> <p>Mbrojtja e baterisë me shkarkim të thellë (UVP)</p> <p>Mbrojtja e daljes së baterisë kundër qarkut të shkurtër dhe lidhje me polaritet të kundërt</p> <p>Tregues optik LED</p> <p>Lloji i mbrojtjes:</p> <p>SCP mbrojtje nga qarku i shkurtër</p> <p>Mbrojtja nga mbitensionet</p> <p>Mbrojtja nga rmbingarkesa OLP</p>	copë	6	130.00 €	780.00 €
5	Bateri 40Ah industriale per funizim pa nderpreje te sistemit te kontrolli te qasjes	<p>Bateri rimbushese 40Ah per vendosje ne furnizuesin e tensionit te kontrollerit</p> <p>Tensioni normal 12V</p> <p>Kapaciteti normal (20HR)40AH</p> <p>Opsioni për ngadalësimin e flakës (FR) UL94: VO</p> <p>Rryma maksimale e shkarkimit 480A (5s)</p> <p>Temperatura e funksionimit. Gama e shkarkimit: -15 ~ 50°C, karikimi: 0 ~ 40°C</p> <p>Ruajtja: -15 ~ 40°C</p> <p>Te jete e dizajnuar per jetëgjatësinë në temperaturar 20°C për 10 vjet</p>	copë	6	100.00 €	600.00 €
6	Bravë Elektrike	<p>BRAVË ELEKTROMAGNETIKE -</p> <p>Brava elektrike duhet të punoj ne logijken qe kur rryma nderprehet brava duhet te jete e mbyllur (Fail Secure)</p> <p>Brava duhet te liferohet komplet me pjesen ballore dhe te jete e kualitetit te lartë si dhe te jete brand name.</p>	copë	25	30.00 €	750.00 €

		Tensioni ne hyrje të jetë 12V DC ose AC; Konsumi: 630 mA në 12VDC, 540mA në 12VAC.				
7	Barvë Bolt për Dyer te Xhamit	<p>Barvë Bolt për Dyer te Xhamit komplet me mbajtës Bravë bolt e pershtatshme për vendosjen ne dyer te qelqit plotësisht pa kornizë, gjatësia e bulonit 16 mm dhe diametri 13 mm me forcë mbajtëse deri në 1000 kg, tension 12V DC, i përshtatshëm për dyer qelqi plotësisht pa kornizë, vonesë kohore e mbylljes automatike të sinjalizimit 0s,3s,6s, ose 9 sekonda</p> <p>Kontakti i daljes së sinjalit të së derës (NC.COM)</p> <p>Mbrojtje e dyfishtë përrrymën e ngarkimit.</p> <p>Ribllokoni automatikisht nëse nuk ka Veprim brenda 5 sekondave, jetë e gjatë me cikël minimum 490000.</p> <p>E prodhuar sipas standardeve te EU – CE Certifikatë</p>	copë	15	90.00 €	1,350.00 €
8	Barvë Magnetike për Dyer te Xhamit dy krahëshe	<p>Barvë Magnetike për Dyer te Xhamit dy krahëshe me 2x750kg – Me mbajtës adekuat per montim</p> <p>Testi i ngarkesës me blokimi magnetik të dyerve 2x 750 kg, tension i dyfishtë 12 VDC</p> <p>MOV siguron mbrojtje kundër rrymës.</p> <p>Projektuar kundër magnetizmit të mbetur.</p> <p>Strehimi alumini i anodizuar i materialit me rezistencë të lartë.</p> <p>Rritja e forcës mbajtëse, Strehimi i dyfishtë mbrojtës.</p> <p>Blokimi magnetik i derës duhet të funksionojë në 20°C~+55°C. E prodhuar sipas standardeve te EU – CE Certifikatë</p>	Cope	10	55.00 €	550.00 €
9	Kartelë	<p>KARTELË MAGNETIKE- Kartë e hollë PVC me frekuencë 13,56 MHz MIFARE ISO me mundesi printimi ne të për foto ID dhe printim teksti me printerë të dedikuar PVC. Te kete memorie ROM 512 bit, frekuencia e funksionimit 13.56 MHz Kushtet mjedisore të funksionimit: temperatura nga -10°C deri në +50°C dimensionet: 0.8 x 54.0 x 85.5 mm Karta duhet të jetë e të njëjtit prodhues si lexuesi dhe të përmbajë numrat e regjistrimit.</p>	Cope	2000	2.00 €	4,000.00 €
10	Hidraulik i derës	<p>Hidraulik i derës (mbyllës i derës)</p> <p>I përshtatshëm për përdorim në dyert me një krahë përpesa nga 85 deri ne 125 kg</p> <p>I përshtatshëm për aplikime të brendshme</p> <p>Certifikuesi i miratuar - Certifikata CF144</p> <p>Vlerësimi i zjarrit: FD120</p> <p>Te jete me pajiset tjera te nevojshme per montim direkt që lejon një instalim të shpejtë dhe të lehtë si dhe eliminon nevojën për një plakë mbështetëse</p> <p>Gjerësia maksimale 1100 mm (madhësia e fuqisë EN 3-4)</p> <p>Fiksim universal për montim anësor me shtytje dhe tërheqje.</p>	Cope	50	50.00 €	2,500.00 €

		E prodhuar sipas standardeve te EU , CE e shënuar sipas EN 1154, EN 1158				
11	Buton per dalje	Buton per dalje - Butoni i daljes duhet me prekje dhe te kete LED dritën e prapme (Backlight). Butoni i daljes duhet te jetë i pershtatshem per montimit në muri.	Cope	40	20.00 €	800.00 €
12	Gyp flexibil metalik përfutjen e kabllit per dyer	Gyp flexibil metalik përfutjen e kabllit edhe e ruan kablin nga demtimi kur behet hapja dhe myllja dhe deres si dhe parandaloni dëmtimin e kabllit me qëllim të keq.	Cope	30	12.00 €	360.00 €
13	Softuer i licensuar për menaxhimin e sitemit të kontrollit të qasjes	Softuer përmes portës serike (COM, USB) ose rrjetit kompjuterik (LAN/WAN) Monitorimi i ngjarjeve në kohë reale në kompjuterë lokalë dhe në distancë Mbështet lexuesit e afërsisë: EM 125 kHz, EM 125 kHz me rreze të gjatë, 13,56 MHz MIFARE® Mbështet lexuesit biometrikë Komandat interaktive përmes kontrollorët Filtrimi i ngjarjeve i përzgjedhur nga operatori Ngjarjet në internet raportojnë në skedarë teksti Njoftimet e ngjarjeve me email Raportet e pjesëmarrjes në çdo zonë të përcaktuar nga përdorues Regjistrimi i kohës dhe pjesëmarrjes Integrimi me sisteme të tjera: T&A, CCTV, Alarm kundër vjedhjes, Alarm zjarri, BMS Vizualizimi i sitemit të punës në sfond grafik (planet e objektit) Konfigurim përmes rezervë automatike Nivele të ndryshme aksesi përmes operatorët e programit Eksporton/importon bazën e të dhënave në skedarë të formatit XML. OLE Automatizimi SDK	Cope	1	1,200.00 €	1,200.00 €
14	Server + monitor	Server + monitor përmes instalimin e sitemit te menagjimit te kontrollit te qasjes dhe sitemit per menagjimin e orarit te punës Serveri duhet të ketë procesorin minimum Xeon E-2224G 4 bërthama 3.5Ghz ose më të avancuar, minimumi 8GB RAM DDR4, 1TB HDD, SSD 240GB, 12gb/s SAS Controller, të ketë port LAN Gigabit Ethernet dhe DVD.	copë	1	1,100.00 €	1,100.00 €

		Monitori duhet te jete minimum 21" dhe te ketë rezolucion Full HD IPS 1920x1080, dritë prapa; WLED, 250 cd/m ² . Monitori duhet të jetë i njëjtë me markën e serverit dhe te dyjet duhet te jene brand name.				
15	Kabell 2x0,75+4x0, 22+SCH	Kabell për komunik dhe furnizim 2x0,75+4x0,22+SCH	m	5200	0.60 €	3,120.00 €
16	Kabillo UTP Cat6	Kablli UTP duhet te jete minimum i kategorise 6, 24AWG te kete mbeshtjellen nga materiali HDPE , te jete bakër (Solid Bare Copper 99.95%) Gjithsthu kablli duhet te jete conform standardit ISO/IEC11801,TIA-568-C.2 UL444. Kablli duhet te jete i pershatshem te instalohet ne ambiente me temperaturo nga -20 °C deri 75 °C.	m	1200	0.55 €	660.00 €
17	Kabell per furnizim	Kabell i rrymës 3x1.5	m	1200	0.55 €	660.00 €
18	Kanale plastike	Kanale plastike me ngjites 16x16mm dhe 25x25mm	m	1800	0.50 €	900.00 €
19	Gyp plastik	Gyp plastik fi 25	m	1000	0.20 €	200.00 €
20	Material tjetër	Material tjeter i pa specifikuar po i nevojshem per perfundimin e puneve		1	400.00 €	400.00 €
21	Montimi dhe konfigurimi i sistemit	Shtrirja e kabllove, montimi dhe konfigurimi i sistemit të kontrollit te qasjes dhe sistemit per menagjimin e orarit të punës (për një lexues/ terminal)		50	110.00 €	5,500.00 €
22	Trajnimi	Trajnimi i stafit për operim me kontrollin e qasjes dhe sistemit per menagjimin e orarit të punës ne -Çmimi për një ditë (kohezgjatje e trajnimit 6 orë)		1	400.00 €	400.00 €
23	Mirëmbajtja	Mirëmbajtja e rregullt sistemit dhe intervenimet emergjente ne rast te ndonje defekti ne kohezgjatje 36 muaj nga data e dorezimit te projektit (cmimi për muaj)		36	160.00 €	5,760.00 €
					TOTALI ME TVSH	44,830.00 €



[Signature]

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Digjitalizimi i sherbimeve dhe proceseve te punës

Qellimi i këtij projekti është furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e sistemi të kontrollit te qasjes me menagjimit të orarit të punës ne objektet e Komunës së Prishtinës.

Për realizimin e këtij projekti janë paraparë të vendosen pajisje të certifikuar dhe të avansuara për të kontrolluar ne menyrën me të mire hyrje-daljet ne objektet e komunes.

Ne menyrë që sistemi të jetë sa me lehtë i mengjueshem janë paraparë të vendosen kontroller të cilët kanë të integruar modulin për qasjen ne rrjet TCP/IP, kontroller të cilët duhet të kenë mundesi te lidhjes dhe kontrollimi të minimum 30 dyreve ne menyrë qe në të ardhmen të kete mundesin e zgjerimit pa patur nevoj te rritet numri i kontrollerve.

Për kompletimin e sistemi janë paraprë vendosje e lexueve, furnizueve të rrymes me bateri me qellim te funksionimit te sistemit ne menyre autonome edhe ne rastet kur ka ndërprerje te rrymes sistemi te jete funksional, pajisjet tjera percjellese, si brava elektrike, magnetike, myllës te dyerive, butona për hapje, zgjerues të sistemit, kabllo dhe te gjitha materialet e nevojshme që sistemi të funksionalizohet.

Me qellim që sistemi të jetë i kompletuar ne kuader të ketij projekti është paraparë, trajnimi i stafit, mirëmbajtja e sistemit për 36 muaj si dhe garancioni 24 muaj për pajisje nga dita pranimit teknik.

Për terminalin e menagjimit te orarit të punës AK mund te kërkoj nga OE- pjesmarres qe te sjellin për moster dhe te demostrojn funksionimin e sistemit ne objektin e Komunës para nënshkrimit të kontratës.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/- 30%



Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 104945

Për KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të Professional Alarm L.L.C.

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe numri i biznesit në vazhdim Operaratori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Digitalizimi i sherbimeve dhe proceseve te punes**

Nr. prokurimit: 616-22-5440-2-2-1

Garacion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke lu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me ketë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **4,483.00€** zotohemti të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilin deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim.

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratene e nënshtkuar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshtkuar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nenkontraktore dhe/ose furnizues të materialeve

Pagesa në shumën e limituar prej **4,483.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1127 ditë kalendarike prej **29.07.2022** deri më **29.08.2025**

Data lëshimit: 29.07.2022

Nënshtimi dhe vula e garantuesit

Ky garacion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

